



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA DURRËS**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr. 46, datë 28.02.2023

**PËR**  
**MIRATIMIN E MANDATIT TË ANËTARES SË KËSHILLIT BASHKIAK**  
**ZJ. LULJETA AGIM METANI**

Në mbështetje të nenit 113, pika 1 dhe 2, të Pjesës së Gjashtë “Qeverisja Vendore” e ligjit nr.8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” e ndryshuar, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, gërma “b”, nenit 49, pika 1 dhe pika 2, nenit 50, nenit 54, pika “j”, nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, të Rregullores së Funksiomit të Këshillit Bashkiak, shkresës të Komisionit Qëndror Zgjedhor me nr.prot 676, datë 07.02.2023, protokolluar me tonën nr.1589 prot., datë 08.02.2023, mbështetur në raportin e Komisionit të Mandateve si dhe pas betimit në Këshillin Bashkiak Durrës, në mbledhjen e datës 28.02.2023,

**KËSHILLI BASHKIAK**  
**V E N D O S I :**

1. Miratimin e mandatit të anëtares së Këshillit Bashkiak Durrës, kandidate në listën shumëmemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, zj. Luljeta Agim Metani.
2. Zj. Luljeta Agim Metani emërohet në Komisionin e Mbrojtjes Civile, Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Shëndetësisë si zëvendësuese e zj.Valbona Begiçi.

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Sekretari Këshillit Bashkiak.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

**KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK**

**Ani Dyrmishi**



**U shpall sot me datë 02.03.2023**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 166/prot.  
12

Durrës, më 13 03 .2023

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit



**KËSHILLIT BASHKIAK  
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË  
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 46 datë 28.02.2023  
“Për miratimin e mandatit të anëtares së Këshillit Bashkiak Zj. Luljeta Agim Metani”

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016  
“Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.  
Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI**

**EMILJAN JANI**

